

RAPORT MONITORIMI ZGJEDHJET NË UNIVERSITETET PUBLIKE

30 KORRIK
2020



QENDRESA
QYTETARE

OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER



1. Hyrje

2. Gjetjet kryesore

3. Procesi zgjedhor

- 3.1 Kontrolli anti – plagjiaturë
- 3.2 Konfliktualiteti mes organeve drejtuese në Universitetin e Tiranës
- 3.3 Fushata zgjedhore

4. Dita e Zgjedhjeve – Universiteti Politeknik i Tiranës

- 4.1 Administrata dhe Infrastruktura zgjedhore
- 4.2 Procesi i votimit dhe mbyllja e tij
- 4.3 Procesi i numërimit
- 4.4 Respektimi i masave anti-covid 19

5. Rekomandime

Shtojca 1. Fisha e vëzhgimit të procesit zgjedhor

Punuan materialin:

Kleana Piu Klevina Zhuri Rigels Xhemollari

Kontribuan si vëzhgues:

Ines Mulellari; Anila Salianji; Tea Zeqaj; Lediana Hoxhaj; Diana Mjeshtri; Erjola Ramazani; Orgesa Zaimi; Celdo Brahimaj; Donada Rata; Teisa Kurti; Fatjon Biba; Dragana Kurti; Ervin Kurti



1. Hyrje

Zgjedhjet në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë u mbajtën në datë 30 Korrik 2020 bazuar në Urdhrin nr.175, dt. 30.06.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ku ndryshe nga zgjedhjet e vitit 2016, secila prej 12 IAL-ve hartuan dhe miratuan vetë rregulloret e tyre të organizimit të proceseve zgjedhore. Sipas ligjit 80/2015 të drejtën për të zgjedhur autoritetet drejtuese (Rektor, Dekan, Përgjegjës Departamenti, Senat Akademik) e kishin: personeli akademik me 90% të peshës së votës dhe studentët me 10% të peshës së votës.

Qëndresa Qytetare monitoroi procesin e nxjerrjes së akteve nënligjore, administrimin e zgjedhjeve dhe verifikimin e plagjiaturave të kandidatëve për autoritetet drejtuese në universitete. Gjithashtu për shkak se zgjedhjet u zhvilluan gjatë periudhës së pandemisë Covid 19, një rol të rëndësishëm kanë marrë dhe masat anti-covid në këtë monitorim. Në këtë studim janë marrë në shqyrtim tre universitetet publike më të mëdha në vend: Universiteti i Tiranës, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Universiteti Politeknik i Tiranës.

Për shkak të mbështetjes juridike dhe publike të një grupi studentësh të cilët me të drejtë vendosën të padisin Universitetin e Tiranës për proces të paligjshëm për shkak të mbarimit të mandatit të Komisionit Institucional Zgjedhor, dhe përjashtimit të një pjesë të studentëve nga e drejta e votës për shkaqe objektive, Qëndresa Qytetare nuk e monitoroi procesin gjatë ditës së zgjedhjeve në Universitetin e Tiranës, duke mos e konsideruar të

ligjshëm deri në një vendim të formës së prerë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Ndërkohë Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka refuzuar kërkesën për akreditimin e vëzhguesve të Qëndresës Qytetare me argumentin se rregullorja e tyre e brendshme nuk e lejon vëzhgimin e procesit zgjedhor nga aktorë të jashtëm.

Universiteti Politeknik i Tiranës aprovoi kërkesën duke akredituar 14 vëzhgues të Qëndresës Qytetare të cilët u vendosën në qendrat evotimi të 7 Fakulteteve të UPT. Vëzhgimi i procesit përfshiu fazën e votimit, atë të numërimit dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore. Rektor i Universitetit u zgjodh Z.Andrea Maliqari me 62.18% të votave përballë kandidatit Vladi Kolic me 37.82% të votave. Në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës kandidatja për Rektor garoi e vetme, ndërsa në Universitetin e Tiranës pati garë mes tre kandidatëve, ku fitues u shpall z. Artan Hoxha.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti monitorues do ti përcillen institucioneve publike të arsimit të lartë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Këshillave Studentore.

Ky raport u realizua nga Qëndresa Qytetare në kuadër të projektit "Arsimi në Fokus", me mbështetjen financiare të Olof Palme Center. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

2. Gjetjet kryesore

- Universitetet publike parashikuan në Rregulloret e zgjedhjeve se çdo kandidat për organet drejtuese duhet të ketë plotësuar formularine vetëdeklarimit të plagjiaturës, duke anashkaluar kontrollin anti-plagjiaturë dhe verifikimin e titujve akademikë të parashikuara në VKM 777 dhe Urdhrin nr.8 të Ministres, si hallka të rëndësishme për integritetin akademik të pedagogëve dhe drejtuesve

- Komisioni Institucional Zgjedhor në Universitetin e Tiranës shkeli Rregulloren e zgjedhjeve, duke vendosur të hapë regjistrimet e kandidatëve për “Rektor” dhe “Anëtar Senati” pa u shpallur zgjedhjet paraprakisht nga Rektori.

- Në dy nga tre universitetet e monitoruara Rektorët u rizgjodhën në pozicionet e tyre. Në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës kandidatja për Rektor garoi e vetme, ndërsa në Universitetin Politeknik të Tiranës pati garë mes dy kandidatëve.

- Universiteti “Aleksandër Moisiu” ndaloi me Rregullore vëzhgimin e procesit zgjedhor nga aktorë të jashtëm duke refuzuar kërkesën ëpr akreditimine vëzhguesve.

- Vetëm tre prej 14 studentëve kandidatë për anëtar senati akademik në Universitetin e Tiranës përgatitën platforma kandidimi, por asnjëri prej tyre nuk arriti të marrë mjaftueshëm vota për tu zgjedhur.

- Pavarësisht temperaturave të larta dhe gjendjes së pandemisë, pjesëmarrja e pedagogëve në këto zgjedhje ishte e lartë me rreth 99% ndërsa pjesëmarrja e studentëve ishte në nivele të ulëta me vetëm 11%.

- 30% e qendrave të votimit u hapën 30 deri në 60 minuta me vonesë nga orari i caktuar në rregullore. Shkak u bë mungesa e organizimit në sallat e votimit dhe vonesa në procesin përgatitor nga administrata zgjedhore.

3. Proçesi zgjedhor

Në 14 janar 2020, Ministrja e Arsimit Besa Shahini urdhëroi fillimin e procesit zgjedhor për drejtuesit e universiteteve në datën 09.04.2020, duke caktuar si datë zgjedhjesh 8 majin 2020. Në 11 Mars vendi kaloi në gjendjen e epidemisë dhe fatkeqësisë natyrore dhe ministrja urdhroi ndryshimin e datës për fillimin e procesit zgjedhor duke e lënë



në datën 11 maj dhe si datë zgjedhjesh caktoi 12 qershorin.¹ Në fillim të muajit maj pati reagime të shumta nga studentët të cilat po formësonin një protestë me bazë në rrjetet sociale për të kundërshtuar urdhrin e ministres për mbajtjen e zgjedhjeve në datën 12 qershor, me argumentin se ky urdhër përjashtonte nga e drejta e votës

rreth 2/3 e studentëve të cilët shin urdhëruar të ktheheshin në universitet në muajin gusht. Një pjesë e tyre pretendonin se e drejta e votës do ju mohoj edhe nga bllokimi i udhëtimit nga qytetet e tyre drejt Tiranës.

Ministrja e Arsimit me urdhërin nr. 104, datë 30.04.2020, minimizoi prezencën e studentëve në universitete, duke urdhëruar rikthimin në auditore vetëm të studentëve që diplomoheshin në muajin Qershor.

Urdhri i Ministres	Data e fillimit të procesit zgjedhor	Data e zgjedhjeve	Statusi
Urdhër Nr. 8	9 Prill	8 Maj	U anulua për shkak të pandemisë
Urdhër Nr. 99	11 Maj	12 Qershor	U anulua për shkak të reagimit të studentëve
Urdhër Nr. 175	30 Qershor	30 Korrik	U mbajtën zgjedhjet në 12 universitete

¹ <http://asa.edu.al/site/wp-content/uploads/2020/02/Urdher-nr-8-dt-14.1.2020-zgjedhje.pdf>

Pas reagimeve dhe padisë të ngritur në Gjyaktë për mohimin e të drejtës së votës nga studentët, Ministria e Arsimit anulloi urdhrin për

mbajtjen e zgjedhjeve në 12 qershor duke mos nxjerrë një datë të re. Pas mbarimit të afatit të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore dhe reduktimit të rasteve të identifikaura me covid 19, Ministria e Arsimit shpalli datën 30 qershor si datë të fillimit të procesit zgjedhor dhe datën 30 korrik si datë për mbajtjen e zgjedhjeve në universitete. Pavarësisht kontestimeve dhe mungesës së kohës në dispozicion për të respektuar të gjitha afatet procedurale, në 30 korrik u zhvilluan zgjedhjet në 12 IAL-të publike në vend.²



3.1 Kontrolli anti - plagjiaturë

Pjesë e Urdhrit të Ministres ishte edhe zbatim i pikës 4 të Urdhërit të mëparshëm nr.8 të janarit 2020, ku thuhet shprehimisht se organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë duhet të realizojnë procesin e garantimit të integritetit akademik të të gjithë kandidatëve që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 30 korrikut. Kjo dispozitë nënkupton faktin se çdo kandidat duhet ti nënshtrohej kontrollit anti-plagjiaturë dhe verifikimit të titujve shkencorë dhe rezultatet të ishin pjesë e dosjes së tij të kandidimit.

Universitetet publike të dakordësuara në heshtje për të mos e realizuar kontrollin anti-plagjiature shpikën një mjet të ri, të

² <https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2020/06/3535-urdher-nr-175-date-30.06.2020-1.pdf>

FORMULAR VETËDEKLARIMI**NË ZBATIM TË RREGULLORES****“PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET****DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN
ALEKSANDËR MOISIU”**

Në mbështetje të Nenit 18/19/20/21 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin Aleksandër Moisiu”, unë....., kandidat për postin....., deklaroj nën përgjegjësinë time për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e Gradës/Titullit shkencor.

Emër Mbiemër

paparashikuar as në VKM nr. 777, as në Urdhrin e janarit 2020 të Ministres së Arsimit i cili u quajt “Formulari i Vetëdeklarimit Anti-Plagjiaturë”.

Universitetet publike parashikuan në Rregulloret e tyre të zgjedhjeve se cdo kandidat për organet drejtuese duhet të ketë plotësuar këtë formular, duke

anashkaluar kontrollin anti-plagjiaturë dhe verifikimin e titujve akademikë si hallka të rëndësishme për integritetin akademik të pedagogëve dhe drejtuesve.

3.2 Konfliktualiteti mes organeve drejtuese në Universitetin e Tiranës



Qëndresa Qytetare mori në monitorim tre universitetet publike me numrin më të madh të studentëve në vend, Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Në Universitetin e Tiranës u evidentuan një sërë parregullsish dhe përplasjesh ligjore mes

autoriteteve drejtuese. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve pranë Universitetit të Tiranës me Vendimin Nr. 2, datë 30.04.2020 vendosi të hapë shpalljen për regjistrimet e kandidatëve për “Rektor” dhe

“Anëtar Senati” nga data 4 Prill deri në 8 maj 2020. Po në të njëjtën datë Rektori i Universitetit të Tiranës shpërndau një deklaratë nëpërmjet të cilës informoi se një grup personash, ish-anëtarë të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, kanë shpërndarë dy vendime të cilat janë në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë dhe Rregulloren e zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës. Ndërsa, me shkresën Nr. 1553, datë 30.04.2020, Rektori i Universitetit të Tiranës kërkoi nga KIZ ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të paligjshme me pasoja për Universitetin e Tiranës për shkak se këtij të fundit i kishte mbaruar mandate për ushtrimin e funksionit. Sipas neneve 6 dhe 7 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për organet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës” zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultete bëhet pas caktimit të datës së zgjedhjeve. Përkatësisht, anëtarët e KIZ zgjidhen tre ditë pas shpalljes së zgjedhjes nga Rektori. Ndërsa, anëtarët e KZF zgjidhen tre ditë pas formimit të KIZ.³ Këto dy komisione që janë përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve në Universitetin e Tiranës nuk u zgjodhën. Vendimi Nr. 2, datë 30.04.2020 është marrë nga ish-anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor, të cilëve ju ka mbaruar mandati dhe nuk mund të ushtrojnë asnjë detyrë lidhur me zgjedhjet e 12 qershorit 2020. Nga ana tjetër, shpallja e zgjedhjeve sipas nenit 5 të Rregullores bëhet nga Rektori i Universitetit. Në këtë kuptim, shpallja e zgjedhjeve nga Komisioni Institucional Zgjedhor ishte në kundërshtim të hapur me këtë dispozitë të Rregullores.

3.3 Fushata zgjedhore

Fushata për zgjedhjet e 30 korrikut ishte e vakët dhe pa pjesëmarrje aktive dhe të drejtpërdrejtë të studentëve. Kjo për shkak se auditorët ishin të boshatisura nga rreziku i pandemisë covid 19, përveç studentëve të viteve të treta bachelor dhe të dyta master të cilët u paraqitën në muajin qershor për të dhënë provimet e diplomave.

³ <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendimi-nr.-5-dat%C3%AB-10.02.2020.pdf>

Kandidatët për pozicionet drejtuese nuk patën kohë të shpalosin dhe prezantojnë platformat e tyre, ashtu sic mungoi edhe llogaridhënia e drejtuesve që rikandidonin për 4 vitet në të cilat kishin qeverisur universitetet apo fakultetet.

Në universitetin e Tiranës dhe atë Politeknik pati garë mes kandidatëve për rektor, ndërsa në Universitetin e Durrësit për pozicionin e rektorit garoi vetëm një kandidate, e cila u rizgjodh në krye të këtij universiteti. Studentët, kandidatë për pozicionin e anëtarit të senatit akademik në Universitetin e Tiranës u përqëndruan në fushatën nëpërmjet rrjeteve sociale. Vetëm tre prej 14 studentëve

kandidatë për anëtar senati akademik në Universitetin e Tiranës përgatitën platforma kandidimi, por asnjëri prej tyre nuk arriti të marrë mjaftueshëm vota për tu zgjedhur.

Platforma Paola Veliasi

Kandidat për Senatin Akademik




PAOLA VELIASI - Kandidat për Senatin Akademik

4 Dita e Zgjedhjeve – Universiteti Politeknik i Tiranës

Qëndresa Qytetare vëzhgoi procesin ditën e zhvillimit të zgjedhjeve, 30 korrik në Universitetin Politeknik të Tiranës duke instaluar 14 vëzhgues të akredituar të cilët u vendosën në qendrat e votimi të 7 Fakulteteve të UPT, nga 2 vëzhgues për secilin fakultet. Vëzhgimi i procesit përfshiu fazën e votimit, atë të numërimit dhe shpalljen e

rezultateve zgjedhore. Rektor i Universitetit u zgjodh Andrea Maliqari me 62.18% të votave përballë kandidatit Vladi Kolici me 37.82% të votave. Procesi ishte i qetë, pa tensione dhe u realizuar kryesisht duke respektuar masat anti-covid 19. Pavarësisht temperaturave të larta, gjendjes së pandemisë dhe përfundimit të procesit mësimor, pjesëmarrja e pedagogëve në këto zgjedhje ishte e lartë me rreth 99% ndërsa pjesëmarrja e studentëve ishte në nivele të ulëta me vetëm 11%.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 56 Prot. Tiranë, më 30/07/2020

V E N D I M
Nr. 18, datë 30/07/2020
P Ë R
SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR REKTOR DHE ANËTARË TË SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS










Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës", nenit 6, pika 2.8, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e zhvilluar në datën 30.07.2020


V E N D O S I:


- Të shpallë rezultatit e zgjedhjeve për Rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik, bazuar në tabelat përmbledhëse të rezultateve të votimit të dërguara nga KZP – të.
- Rezultati i zgjedhjeve për Rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik, paraqitet i përmbledhur në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.
- Ky vendim vendim është i ankimeshëm sipas nenit 38 të Rregullores së Zgjedhjeve.

Ky vendim lyp në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Gjergji ISLAMI	Kryetar	
Bexhet KAMO	Anëtar	
Lindita DHAMO	Anëtar	
Albina BASHIOLLI	Anëtar	
Spartak KUÇAJ	Anëtar	
Albana HIASIMI	Anëtar	
Blerina KOLGJINI	Anëtar	
Anjeza GJINI	Anëtar	
Lirgys MLIDA	Anëtar	



Sekretare: Doniza QAFIJA 

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 4, Tiranë. tel/fax: 00355 4 2227814, web: www.upi.al

1

4.1 Administrata dhe infrastruktura zgjedhore

Administrata zgjedhore në Institucionet e Arsimit të Lartë përbëhet nga tre nivele:

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ): KIZ përbën organin më të lartë për administrimin e zgjedhjeve në një universitet. Ky komision përbëhet në çdo rast nga të paktën pesë anëtarë (përbërja është gjithmonë numër tek) të zgjedhur me votë të fshehtë nga Senati Akademik. Ndër të tjera, KIZ ka për detyrë organizimin e procesit zgjedhor në universitet, regjistrimin e kandidatëve dhe shpalljen e rezultateve për Rektor dhe Senat Akademik, krijimin e KZF-ve, etj. Kandidatët për Rektor kanë të drejtën e një përfaqësuesi pranë KIZ, si një ex-officio, pa të drejtë vote.

Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultete (KZF): KZF përbën organin më të lartë të administrimit zgjedhor në njësinë kryesore. Përbëhet nga një numër tek anëtarësh dhe në çdo rast jo më i vogël se tre anëtarë, ku njëri është përfaqësues studentor. Kandidatët për KZF vetkandidohen. Ndër të tjera, KZF regjistron kandidatët dhe shpall rezultatet për Dekan dhe drejtues të njësive bazë, emëron KQV-të, publikon listat e zgjedhësve, shërben si KQV kur njësia kryesore ka vetëm një QV, numëron votat, etj. Kandidatët për Dekan dhe përgjegjës të njësive bazë kanë të drejtën të kenë një përfaqësues të akredituar pranë KZF-së.

Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV): Krijohet nga KZF për çdo QV kur në njësinë kryesore ka më shumë se një QV. Përbëhet nga një numër tek anëtarësh të vetkandiduar, në çdo rast jo më pak se tre anëtarë, ku njëri është përfaqësues studentor. Kandidatët për KQV vetkandidohen. KZF ka për detyrë përgatitjen e QV-së dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve.

Administrata zgjedhore përgjithësisht ka respektuar rregulloren duke marrë masat e nevojshme për realizimin e një procesi zgjedhor të rregullt duke afishuar listat e votuesve, duke siguruar fshetësinë e votës dhe duke publikuar udhëzimet mbio procesin e votimit.

Pavarësisht masave të marra rreth 30% e qendrave të votimit u hapën 30 deri në 60 minuta me vonesë nga orari i caktuar në rregullore. Dy qendrat e votimit në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit vonuan nisjen e procesit për shkak të problemeve me ndarjen e sallave të votimit, ndërsa vonesat në qendrat e tjera

erdhën për shkak të vonesës në procesin përgatitor nga administrata zgjedhore.

Përfaqësuesi studentor në KQV-të nuk ishte i identifikueshëm dhe në disa raste pas interesimit të vëzhguesve u vu re se disa KQZ ishin të përbërë vetëm nga stafi akademik. Në qendrën e votimit nr.2 pranë



Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit u identifikuan nga vëzhguesit kuti votimit me logon e Partisë Socialiste. Këto kuti pas raportimit dhe denoncimit në media nga ekipi i Qëndresës Qytetare u spastruan nga logot e mbivendosura nga administrata zgjedhore.

4.2 Procesi i votimit dhe mbyllja e tij

Votimi në Universitetin Politeknik të Tiranës u krye konform Rregullores dhe pa probleme. Në përgjithësi komisionet e QV-ve qenë vazhdimisht në krye të detyrës, duke bërë të mundur që votuesit të votonin sipas rregullave dhe të drejtave. Të gjithë zgjedhësit përpara momentit të votimit treguan ID ose pasaportën përpara komisionit, ndërkohë individët emri i të cilëve nuk figuronte në listat e votimit, nuk u lejuan të votonin. Administrata zgjedhore u bëri thirrje vëzhguesve të pavarur për të mos përdorur aparate celulare në ambientet e votimit, por nga ana tjetër u vu re se disa votues nga momenti që futeshin në sallë dhe derisa mbaronin procedurën e votimit mbanin dhe përdornin aparatet celular me vetë në mënyrë të dukshme.

Nga ana tjetër, nuk munguan rastet e propagandës pranë qendrave të votimit dhe ushtrimit të presionit kundrejt votuesve ku vëzhgues të

kandidatëve për Rektor bënin propagandë dhe ndikonin votues të studentëve për të marrë pjesë në zgjedhje. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike Studentëve nuk ju vendos asnjë shenjë identifikuese pas votimit.

Mbyllja e QV-ve në të gjitha fakultetet e vëzhguara u krye me rregull dhe qetësi të plotë, meqenëse edhe fluksi i votuesve pothuajse kishte reshtur. Me përjashtim të disa QV-ve në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Inxhinierisë Mekanike, të cilat u mbyllën në 16:30, të gjitha QV-të e tjera u mbyllën në kohë. Pavarësisht vështirësive më sipër, çdo procedurë e vendim i komisioneve u krye në transparencë të plotë, në praninë e vëzhguesve.

4.3 Procesi i numërimit


Procesi i numërimit vijoi i qetë dhe pa probleme. Numërimi u krye në mënyre transparente dhe mosrespektimi i të gjithë hapave nuk çënoi procesin e numërimit dhe rezultatet e zgjedhjeve. Përgjithësisht në të gjitha fakultetet e UPT procesi i numërimit u karakterizua nga problematikat e mëposhtme:

1. Në dy raste fletët e votimit u ndanë në grupe pa thënë ndërkohë emrat e personave të votuar. Numërimi i votave dhe shqiptimi me zë të lartë i emrave të të votuarve u bë pas grupimit në fjalë.
2. U pranuan si të vlefshme vota, shenja e të cilave dilte jashtë kutisë se përcaktuar për votim.
3. Votat e hedhura në kutitë e gabuara përgjatë procesit të votimit u shtuan përgjatë procesit të numërimit nga ana e numëruesve në kutitë përkatëse dhe u konsideruan si vota të rregullta.
4. Votat e cilësuar si jo të rregullta, në fund të procesit të numërimit u cilësuan si të rregullta dhe u përfshinë në llogaritje.
5. Pas njohjes me rezultatet e votimit për Drejtues të Njësisë Kryesore, në sallën e numërimit pati ovacione nga numëruesit.

4.4 Respektimi i masave anti-covid 19

Për shkak se zgjedhjet në universitete u zhvilluan gjatë kohës së përhapjes së pandemisë Covid - 19 universitetet u detyruan të marrin masa për veprimtarinë mësimore dhe zgjedhore. Universiteti Politeknik i Tiranës miratoi më 30/05/2020 Rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit covid – 19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në UPT” e cila shërbeu si document orientues edhe ëpr masat anti covid 19 në zgjedhjet e datës 30 korrik 2020.⁴ Gjatë procesit zgjedhor në 7

fakultetet e UPT përgjithësisht u respektuan masat mbrojtëse ndaj Covid 19, me përjashtim të rasteve ku jo çdo pjesëmarrësi në zgjedhje iu mat temperatura në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe gjatë procesit të numërimit në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit nuk u respektua distanca 2 metër mes komisionerëve. Gjithashtu në hyrje të qendrave të votimit shpesh u vunë re grumbuj votuesish pa maska dhe në distance nën 1.5 metra nga njëri-tjetri, veç ndërgjegjësimit të tyre të ulët, kjo vinte dhe si pasojë e infrastrukturës së munguar në këto ambiente.



⁴ <https://www.upt.al/images/stories/menu/Rregullore%20per%20marrjen%20e%20masave%20per%20parandalimin%20e%20perhapjes%20se%20covid%2019.pdf>

Rekomandime

- Parlamenti i Republikës së Shqipërisë duhet të votojë projektligjin e propozuar nga Qëndresa Qytetare dhe studentët për rritjen e peshës së votës studentore në masën 30%.

- Universiteti i Tiranës duhet të organizojë menjëherë zgjedhjet për Komisionin Institucional Zgjedhor të ri dhe Komisionet zgjedhore të Fakulteteve.

- Rektori i Universitetit të Tiranës duhet të shpallë menjëherë datën e zgjedhjeve për Këshillat Studentore, të cilave u ka përfunduar mandati.

- Këshillat e Etikës duhet të fillojnë menjëherë zbatimin e VKM nr.777 për kontrollin anti-plagjiaturë të drejtuesve të zgjedhur në 30 korrik nëpërmjet platformës academia të vënë në dispozicion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

- Rregullorja e Universitetit “Aleksandër Moisiu” duhet të parashikojë shprehimisht pjesëmarrjen e vëzhguesve të pavarur në procesin zgjedhor të IAL. Vëzhguesit e pavarur do të risinin transparencën dhe besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe atë të vetë institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri.

- Qendrat e votimit duhet të hapen dhe mbyllen në kohën e caktuar në Rregullore përveç rasteve kur ka specifikime të tjera.

- Komisionerët duhet të informohen më mirë mbi të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesve për të evituar abuzimet edhe nga ana e tyre brenda QV-ve.

- Nevojitet një përpjekje më e madhe për të edukuar votuesit mbi subjektet që ata po votojnë dhe platformat e tyre.

- Rregullorja për Zgjedhjet në IAL duhet të përcaktojë si procedurat për vlefshmërinë e votave të hedhura në kutitë e gabuara ashtu dhe procedurat për numërimin e këtyre votave.

Shtojca 1. Fisha e vëzhgimit të procesit zgjedhor

NR	Procesi i votimit (sheno me X)	PO	JO	Koment
A) INFRASTRUKTURA DHE DOKUMENTACIONI PËR ZGJEDHJET				
1	Qendra e Votimit u hap në 8:00 .			
2	Ne mjediset e Fakultetit jane publikuar listat e zgjedhesve.			
3	Nje prej 3 anetareve te KQV është student.			
4	A është e vendosur selia e KZF në mesin e aktivitetit mësimor ose kërkimor njësisë kryesore ?			
5	Dhoma e votimit siguron fshehtësinë e votes dhe intimitetin e votuesit.			
6	Ne ambientet e votimit janë të publikuara udhëzimet per procedure e kryerjes se votimit.			
7	1 Ore para nisjes se procesit te votimit, KZF u tregoi vëzhguesve kutite bosh.			
8	Kutite e votimit ishin transparente.			
9	Ne ambientet e votimit vëzhguesit nuk bejne propogande per kandidatet.			
10	Fleta e votimit permban te gjitha elementet e parashikuar ne nenin 31 te rregullores.			
11	Fletët e votimit për studentët a e ka të shkruar në sfondin e saj cilësimin "Për Studentët"?			
B) PROCEDURA E VOTIMIT				
12	Votuesit nuk kishin celular ose aparat me vete gjate kryerjes se procedures se votimit.			
13	Zgjedhesit tregojne ID ose Pasaportën para Komisionit te Votimit.			
14	Gjatë verifikimit të emrit të votuesve përpara se të pajisen me fletët e votimit, a kanë pasur probleme me të dhënat e cdo votues (student/staf akademik)			
15	Gjatë procesit të votimit u ruajt distanca 2 metër ndërmjet personave të pranishëm.			
16	A u votua jashtë dhomës së votimit?			
17	Nëse u votua jashtë dhomës së votimit, a u lejuan që këto fletë votimi të hidhen në kutitë përkatëse?			
B.1) MASAT E MARRA PER COVID19 GJATË VOTIMIT				
18	Në ambientet e votimit ishin instaluar dezinfektantë për përdorim nga votuesit dhe stafi që administronte zgjedhjet.			

19	Stafi administrues i zgjedhjeve ishte i pajisur me maska mbrojtëse ndaj covid 19			
20	Votuesit që morrën pjesë në zgjedhje ishin të pajisur me maska mbrojtëse ndaj Covid 19			
21	Çdo personi pjesëmarrës në ambientet e votimit iu mat temperatura para hyrjes			
C) MBYLLJA E VOTIMIT				
22	Mbyllja e votimit u realizua ne oren 16:00?			
23	A u votua pas orës 16:00? Nëse po, si u procedua			
24	Nëse u votua pas orës 16:00, sa është numri i votuesve?			
25	Kryetari i KZF shënoi numrin e zgjedhësve që kanë votuar në proceverbal.			
26	Sa ishte numri i votuesve në përfundim të votimit?			
27	Kryetari i KZF deklaroi me zë të lartë shifrat e pjesëmarrjes në votim përpara vëzhguesve.			
28	A u realizua mbyllja e kutive sipas rregullores, duke u shoqëruar me elementet e sigurisë?			
29	Vëzhguesit shoqëruan kutitë në vendet e numërimit.			
D) PROCESI I NUMERIMIT				
30	Kryetari i KZF/KIZ hap kutitë e votimit sipas rradhës dhe bën vlerësimin e votave duke i vendosur ato një për një mbi tavolinë.			
31	Votat e pavlefshme u ndanë në grupe të vecanta ose ftoi vëzhguesit të verifikojnë fletët e dëmtuara.			
32	Kryetari i KIZ numëroi ose ftoi vëzhguesit të verifikojnë fletët bosh.			
33	A u zhvillua numërimi i votave sipas rradhës së kutive (neni 37) - Rektor - Dekan - Shef Departamenti - Anëtar i Senatit Akademik - Anëtar i komisionit të përhershëm			
34	A u bë transparentë tabela e votave për çdo kandidat?			
35	A u bë transparente tabela e votave përfundimtare dhe u nda jo me vëzhguesit dhe përfaqësuesit e ministrisë?			
36	Procesi i numerimit ishte transparent për vëzhguesit dhe publikun.			
D.1) MASAT E MARRA PER COVID19 GJATË NUMËRIMIT				
37	Në ambientet e votimit ishin instaluar dezinfektantë për përdorim për monitoruesit dhe numeruesit			
38	Monitoruesit ishin të pajisur me maska			
39	Numeruesit ishin të pajisur me maska dhe ishin të vendosur në distance 2 meter njeri nga tjetri gjatë procesit të numerimit			
40	Çdo personi pjesëmarrës në ambientet e votimit iu mat temperatura para hyrjes.			

Shtojca 2. Foto nga terreni



RAPORT MONITORIMI ZGJEDHJET NË UNIVERSITETET PUBLIKE

30 KORRIK
2020